



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universitet Prizren <b>"UKSHIN HOTI"</b>	
Pranuar me dt.	11.10.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-398

## KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel: +381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Prizren, më 20.09.2019

Në mbështetje të nenit 95 paragrafi 2 pika 2.4 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit në mbledhjen e mbajtur me datë 20.09.2019, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Themelohet Universiteti Veror Ndërkombëtar në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren
- II. Universitetit Veror Ndërkombëtar në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren do të mbikëqyret nga Zyra për marrëdhënie me jashtë, mënyra e funksionimit do të përcaktohet me rregulloren e funksionimit të Universitetit Veror Ndërkombëtar në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm që të iniciojë procedurat për plotësimin e zyrës me punonjësit përkatës në bazë të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

### A r s y e t i m

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 20.09.2019, me qëllim të krijimit të lidhjeve të drejtpërdrejta të stafit akademik dhe studentëve të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", me universitete rajonale dhe ndërkombëtare, ku parashihet avancimi i metodologjisë së mësimdhënies dhe rritja e kapaciteteve kërkimore e stafit akademik, me qëllim që të sjell në Kosovë studentë nga rajoni, Evropa dhe nga e gjithë bota, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kopje e Vendimit i dërgohet:

- Këshillit Drejtues
- Menxhmentit
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Njësi Akadematike
- Zyrës së Personelit
- Arkivit

Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Kryesues i Këshillit Drejtues

